

RAPORT

Vlerësimi dhe zhvillimi i zinxhirit të vlerës së MAPs
(Bimët Medicinale Aromatike) në KKPA (Zona e Mbrojtur
Korab-Koritnik)

JANAR 2023

Ky raport është publikuar nga organizata World Vision Albania në kuadër të projektit "Përmirësimi i jetesës përmes ruajtjes së biodiversitetit të parkut natyror Korab-Koritnik", financuar nga Prespa Ohrid Nature Trust – PONT.

Raporti është hartuar nga:

- Prof. Dr. Alban Ibrahimi
- Dr. Zyber Gjoni

Grupi teknik mbështetës:

Majlinda Hoxha, Këshilltare Teknike, World Vision Albania
Erblin Burnazi, Manaxher Projekti, World Vision Albania

Raporti mund të përdoret lirisht nga grupet e interesit. Në çdo rast, shumëfishimi ose ripublikimi i këtij raporti duhet të shoqërohet me autorizimin e World Vision Albania dhe PONT.

PËRMBAJTJA

1 HYRJE	4
2. IDENTIFIKIMI DHE INVENTARIZIMI I AKTORËVE KRYESORË TË PËRFSHIRË NË ZINXHIRIN E VLERËS SË BMA-VE NË RAJONIN E DIBRËS SI DHE NË NIVEL KOMBËTAR.....	5
3. IDENTIFIKIMI I 5 BMA-VE TË KULTIVUARA MË TË KËRKUARA NË TREGJET KOMBËTARE DHE NDËRKOMBËTARE DHE TË REKOMANDUARA PËR KULTIVIMIN NË ZONËN E DIBRËS.....	6
3.1 RIGONI.....	9
3.2 CIANI (KOKOÇELI)	11
3.3 MËLLAGA	13
3.4 KALENDULA.....	15
3.5 AGULIÇJA	17
4. IDENTIFIKIMI I PESË VENDEVE MË TË MUNDSHME PËR KULTIVIMIN E BMA-VE.....	21
5. PËRFUNDIMET / KONLUZIONET	22

1 Hyrje

Qëllimi kryesor i këtij studimi është nxitja e fermerëve të qarkut Dibër në kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore, i cili vlerësohet si një sektor që gjeneron të ardhura të qëndrueshme ekonomike për fermerët. Objektivat specifike të këtij studimi janë: (i) identifikimi i 5 BMA-të kultivuara më potenciale të KKPA Dibër për t'iu qasur tregut dhe për të siguruar të ardhura nga komunitetet që përdorin këto potenciale; (ii) Identifikimi i partnerëve lokalë dhe kombëtarë të angazhuar në bimët aromatike mjekësore (MAPs); (iii) Vlerësimi i interesit të secilit partner për grumbullimin e bimëve mjekësore dhe aromatike nga zona e Dibrës; (iv) Identifikimi 5 MAPs më të kërkuara në tregjet kombëtare dhe botërore dhe të rekomanduara për kultivimin në zonën e Dibrës; (v) Identifikimi i top pesë rajoneve më të mundshme për kultivim në zonën e Dibrës dhe përcaktimi i specieve që përshtaten si kulturë mbjellëse për secilin rajon.

Në vitin 2022, eksportet shqiptare të bimëve aromatike dhe mjekësore kanë qënë 12,060 ton, të cilat kanë gjeneruar një të ardhur rreth 41.5 milionë Euro (*Eurostat*). Vlerësohet se pjesa më e madhe e këtyre eksporteve vijnë nga vjeljet e bimëve spontane të egra. Sipas të dhënave të Instat në nivel kombëtar gjatë vitit 2021 është kultivuar një sipërfaqe totale prej 6,830 ha me BMA. Peshën më të madhe e zë Malësia e Madhe, ku janë kultivuar gjithsej 5,200 ha me BMA, kryesisht sherebelë (3,500 ha), helychrysum (500 ha), lavander 200 ha, trumëz (100 ha), rigon (50 ha), etj.

Qarku i Dibrës zë një vend modest në kultivimin e BMA-ve. Sipas Instat janë vetëm 6 ha të kultivuara me BMA në këtë qark në vitin 2021. Bimët kryesore që kultivohen aktualisht në këtë qark janë ciani dhe tërfili i kuq. Ndërkohë, qarku i Dibrës është një nga furnizuesit më të mëdhenj më lëndë të parë, BMA të thara për kompanitë e eksportit në Shqipëri. Ky është një tregues i qartë se sektori i BMA-ë në qarkun e Dibrës është i bazuar gjerësisht në vjeljen e bimëve spontane.

Ndërkohë, ka një potencial të madh për kultivimin e BMA në Dibër, që deri më sot, nuk është vlerësuar si duhet nga fermerët dhe nuk i është kushtuar vëmendje nga aktorët tjerë të zinxhirit të vlerës. Me interes të veçantë për kultivim janë ato bimë, që kultivohen për pjesën e lules (psh., ciani, kalendula, mëllaga, helichrysim, agulicja, etj.). Në vendet e zhvilluara këto bimë kultivohen shumë pak për shkak të kostos së lartë të punës. Kërkesa për këto BMA është shumë e lartë nga Gjermania, Austria, Franca, etj., dhe furnitorët kryesorë të këtyre tregjeve janë vende më pak të zhvilluara si Egjipti, Bullgaria, Shqipëria, etj. Po kështu, me interes janë dhe shumë bimë

mjekësore që vilen si gjethe, si psh, sherebela, rigoni dhe trumza. Së fundmi, dhe kultivimi i BMA-ve për prodhimin e frutave, si trëndafili i egër është me interes të lartë.

2. Identifikimi dhe inventarizimi i aktorëve kryesorë të përfshirë në zinxhirin e vlerës së BMA-ve në rajonin e Dibrës si dhe në nivel kombëtar.

Ka një strukturë të fragmentuar të zinxhirit të vlerës të BMA-ve si në nivelin e qarkut Dibër ashtu edhe në nivel kombëtar. Fermerët janë të vegjël dhe të paorganizuar në kooperativa ose grupe prodhuesish. Janë disa grumbullues të vegjël, 1 deri në 2 për cdo njësi administrative, 1 grumbullues i madh për të gjithë qarkun e Dibrës, ndërkohë që nuk ka kompani eksportuese. Në nivel kombëtar janë 31 kompani eksportuese të BMA – ve, ndërkohë që 10 prej tyre janë të angazhuar dhe në distilimin dhe shitjen e vajrave esenciale.

a) Fermerët e kultivimit të BMA-ve

Janë rreth 26 familje fermere që janë të përfshira aktualisht në kultivimin e BMA-ve në qarkun e Dibrës. Xhevahir Elezi, Ledio Suto, Eduart Torba, Latif Jani dhe Hajrije Mehmeti janë disa nga fermerët liderë, të cilat janë trajnuar për kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore. Këta fermerë do të jenë një shembull shumë i mirë, për të nxitur dhe fermerë të tjerë të zonës në kultivimin e BMA-ve.

b) Grumbullues të vegjël të BMA-ve

Janë rreth 10 grumbullues të vegjël të BMA-ve që operojnë në nivel njësie administrative osë në nivel fshati. Këta grumbullojnë BMA nga fermerë të vegjël dhe furnizojnë operatorin kryesor të grumbullimit të BMA-ve për qarkun e Dibrës.

c) Grumbullues i madh

Ka një grumbullues të madh në Qarkun e Dibrës. Ky është subjekti “Eduard Gjoni”, i cili administrohet nga z. Zyber Gjoni. Kompania shërben si urë lidhëse midis fermerëve dhe grumbullesve të vegjël, me kompanitë e mëdha të eksportit.


d) Kompanitë e eksportit

Nuk ka kompani eskortuese që operon në qarkun Dibër. Në nivel kombëtar gjithsej 31 kompani eksportuese të BMA-ve. Ndër më kryesorët mund të përmendim Gjendra, Filipi, Xherdo, Muçaj, Biobes Elba-Shehu, Albanian Herb, Herba-Fructus Natyrore, Relikaj, MEIA, Cibuku, ATC, Arif Daci, etj.

Këto kompani kanë krijuar lidhje të forta tregtare me blerës të huaj dhe eksportojnë rregullisht BMA të thata, fruta dhe vajra esencialë. Janë të furnizuara nga grumbullesit lokalë dhe kompanitë e vogla përpunuese nga i gjithë vendi. Shumë prej këtyre kompanive, si Elba Sheha, Relikaj, Muçaj, Çibuku, Biobes dhe të tjerë janë të angazhuar direkt ose indirekt përmes mbështetjes së tyre për fermerët vendas në kultivim. Kapaciteti i kompanive të mëdha përpunuese dhe eksportuese varion nga 500 deri në më shumë se 200 Mt BMA në vit, dhe xhiroja e tyre është nga 3 deri në 6 milionë euro.

3. Identifikimi i 5 BMA-ve të kultivuara më të kërkuara në tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare dhe të rekomanduara për kultivimin në zonën e Dibrës.

Eksportuesit e bimëve aromatike dhe mjekësore të intervistuar pohojnë se ka një kërkesë të lartë për BMA-të e Shqipërisë. Tregu më i madh i eksportit në BE është Gjermania ku gjatë vitit 2022 janë eksportuar 3,207 ton BMA, ndërkohë që në SHBA janë eksportuar 3,028 ton (*Eurostat*). Drejt këtyre dy vendeve eksportohet më shumë se 50% e BMA-ve të Shqipërisë.



Gjithashtu tregje të rëndësishme të BMA-ve janë Turqia, Franca, Italia, Polonia dhe Republika Çeke.

Ekportuesit pohojnë se ka një kërkesë në rritje për BMA-të e Shqipërisë nga tregjet e mëdha. Megjithatë, ata e vlerësojnë me risk të lartë varësinë nga BMA-të e florës spontane. Sipas tyre, shfrytëzimi pa kriter i florës spontane rrezikon seriozisht pakësimin ose zhdukjen e disa llojeve të BMA-ve, gjë që dëmton jo vetëm mjedisin por dhe qëndrueshmërinë e biznesit së tyre në plane afatmesme. Përpos kësaj, ata ngrenë shqetësimin e rënies së numrit të vjelësve të florës spontane. Ky është një aktivitetet që zhvillohet kryesisht nga mosha e mesme ose e madhe e popullsisë së zonave të thella rurale. Të rinjtë nuk e shohin me interes ekonomik përfshirjen e tyre në vjeljen e BMA-ve të florës spontane. Për rrjedhojë, mungesa e fuqisë punëtore pas 10 – 15 vitesh do të jetë e dukshme.

Për të siguruar qëndrueshmërinë e sektorit të BMA-ve, eksportuesit po i kthejnë sytë gjithmonë e më shumë drejt kultivimit. Ata pohojnë se po nxisin shumë fermerë që të përfshihen në kultivimin e bimëve aromatike dhe mjekësore. Ata vënë theksin në përfitimet e larta ekonomike që mund të sjellë një fermë me sipërfaqe të vogël, që është tipike për fermat shqiptare, nëse në vend të kulturave tradicionale, përfshihen në kultivimin e BMA-ve. Sipas tyre, Malësia e Madhe është zona me përfshirjen më të lartë të fermerëve në kultivimin e BMA-ve. Këtu kultivohet kryesisht sherebela dhe helychrysum, por dhe BMA të tjera si rigoni, lavandula, trumza, etj.

Gjitashtu, iniciativa shumë të mira të përfshirjes së fermerëve ka në zonën e Korçës, ku shumë fermerë janë përfshirë në kultivimin e cianit, si dhe në zonën e Elbasanit ku mbizotëron kultivimi i cainit, i levandulës dhe rignonit. Në jug, në qarkun e Gjirokastrës janë disa iniciativa të mira të kultivimit të çajit të malit.

Të pyetur se cilat BMA janë më me interes për fermerët e zonës së Dibrës ata vënë theksin në BMA-të që kultivohen për lule. Katër nga këto kanë kërkesë të lartë nga tregjet e eksportit: ciani i kaltër, aguliçja, mëllaga dhe kalendula. At pohojnë se ndjejnë vështirësi për të plotësuar sasinë e kërkuar nga klientët e tyre për lulet e këtyrë BMA-ve.

Ndërkohë, për BMA-të që kultivohen për herb, eksportuesit dhe ekspertët e fushës këshillojnë kultivimin e rignonit në zonën e Dibrës.

Pra, bazuar në këto vlerësime dhe në kërkesën e lartë, 5 bimët e përzgjedhura për kultivim në zonën e Dibrës do të jenë: rigoni, ciani, mëllaga, kalendula dhe aguliçja.

Vlen të theksohet se të pesta këto bimë gjenden në florën spontane të zonës së Dibrës, një tregues që mbështet idenë se kultivimi i këtyrë BMA-vë në zonën e Dibrës është plotësisht i mundur, ndërkohë që garanton cilësi dhe rendiment të lartë.

Disa eksportues shqiptarë janë duke ndërmarrë iniciativa të modelit të kontraktimit të fermës. Ata lidhin marrëveshje bashkëpunimi me fermerë, duke u dhënë fara dhe fidanëve të BMA-ve, me kushtin që këta të shesin pranë eksportuesve produktet e tyre. Këto janë marrëveshje me interes të dyanshëm. Fermerët marrin falas ose kundrejt një çmimi të ulët materialin mbjellës bimor, ndërkohë që eksportuesit sigurojnë lëndën e parë për eksport për të cilën kanë nevojë.

Eksportuesit pohojnë se kanë kërkesë të lartë për BMA të çertifikuara si organike. Kështu që cdo fermer i zonës së Dibrës, i cili do të angazhohej në kultivimin e BMA-ve duhet të synojë të aplikojë praktikat e kultivimit organik dhe të çertifikohet sipas këtij standarti.

Në përzgjedhjen e 5 BMA-ve me interes për kultivim në zonën e Dibrës është marrë në konsideratë dhe cikli i shkurtër i hyrjes në prodhim. Ciani, aguliçja, mëllaga dhe kalendula janë bimë një vjeçare me cikël të shkurtër që hyjnë shpjet në prodhim. Në këtë mënyrë, fermeri do të arkëtojë të ardhura në një kohë të shkurtër 3 – 7 muaj nga mbjellja, në varësi dhe të kohës së mbjelljes (në pranverë ose në vjeshtë).

Nëse qeveria shqiptare do të aplikonte politika të nxitjes së kultivimit të BMA-ve përmes skemave të mbështetjes dhe subvencionimit, me shumë interes do të ishte kultivimi i bimëve që janë në rrezik zhdukjeje dhe që u përdoren rrënjët. Këto përfshihen sanzi (*Gentiana lutea*) dhe salepi (Orchids). Duke qënë se këto janë kultura shumëveçare dhe do të duhen 2 deri në 3 vite, që fermeri ynë i varfër të arkëtojë të ardhura nga kultivimi i tyre. Pa një politikë subvencioni, as që mund të mendohet që një fermer i Dibrës të ndërmarrë një iniciativë të tillë. Por nëse do të kishte një mbështetje të fermerëve, atëherë kultivimi i tyre do të ishte me shumë interes dhe tregu për shitjen është i garantuar.

Në vijim jepet një përshkrim i shkurtër botanik i pesë bimëve të përzgjedhura për kultivim në qarkun e Dibrës, përhapja e tyre dhe teknologjia e kultivimit.

3.1 Rigoni

Përshkrimi: Bimë barishtore shumëveçare, aromatike, 30 - 80 cm e lartë, kërcëj të drejtë dhe pak të degëzuar që i japin bimës pamjen e një çadre të vogël. Gjethet janë të përkundrejta, me bisht të shkurtër, vezake, buzëplota ose të çara lehtas, të veshura me qime bojë hiri. Lulet me bisht të shkurtër janë grumbulluar në kallinj të stërgjatur në mes të kërcëjve. Lulëzon nga fundi i muajit Qershor dhe vazhdon deri nga mesi i Gushtit. Fruti përbëhet nga 4 akenëza, në formë vezake, pak a shumë me qoshe. Ngjyra është e murrme deri në të zezë.

Përhapja: Kjo bimë rezulton të jetë e zakonshme në pjesën jugore të vendit tonë dhe më pak në Tiranë-Elbasan dhe në zonën verilindore të vendit. Rigoni i bardhë gjendet me dendësi të madhe në kurrizet shkëmbore të malësive të Sarandës, në Konispol dhe në Vrinë. Po kështu gjendet në malin e Gjerë në Dropullin e Poshtëm, Pojan, Lunxhëri, Zagori, Nemërçkë, Trebeshinë, Dhëmbel, Kurvelesh, Tepelenë, Vlorë, në faqet shkëmbore të Shpiragut, Tomorrit, në formacionet e Mallakastrës në kurrizet kodrinore të Lushnjës, Peqinit, në rrethin e Tiranës gjendet në fshatrat Pezë, Grecë, Vrap, Baldushk, Linzë, Krrabë si dhe në pjesën e poshtme të Dajtit.

Klima dhe toka: Nga përcaktimi që i bëmë përhapjes së rigonit, nxjerrim në dukje edhe kërkesat e kësaj bime për klimën dhe tokën. Si klimë rigoni rritet e zhvillohet në zonat me klimë të ngrohtë, duke filluar nga kodrinat bregdetare e deri në lartësitë 800-900 m mbi nivelin e detit. Tokat më të

preferuara të kësaj bime janë ato ranoro-gëlqerore ose argjilo-ranore-gëlqerore, tokat gurore dhe sidomos vendet e thata. Si pjesë të perdorshme të bimës janë gjethet dhe lulet. Duke parë kërkesat e tregut të brendshëm e të jashtëm për rigon, kultivimi i saj është me leverdi ekonomike mjaft të kënaqshme.

Kultivimi: Për interesin e punës sonë do të mbështetemi në dy mënyrat e kultivimit të kësaj bime:

Mbjellja me fidanë të rrënjëzuar.

Fidanët përgatiten në fidanishte. Fidanishtja parapërgatitet në një vend të sheshtë, të kulluar, që të mos rrihet nga erërat e ftohta, të jetë me ekspozim nga dielli dhe të ketë afër ujë për vaditje. Sipërfaqja e fidanishtes, bëhet në formë vullajash me gjerësi 1.2 m (ndërsa gjatësia e vullajës sipas madhësisë së fidanishtes) dhe shkrifërohet imët pa e ngjeshur. Po të kemi pluhur të mbeturinave të gëlqerës e shpërndajmë dhe bëjmë përzierjen me dhé. Mbjellja e farës ka diapazon të gjerë që fillon nga Prilli deri në Korrik, por më e përshtatshme është mesi i muajit Maj. Për çdo m² hidhet 5-6 g farë. Pas shpërndarjes së farës sipërfaqja e fidanishtes ngjishet me dërrasë. Çdo ditë i bëhet ujitje deri në mbirjen e plotë, pastaj rrallohet hedhja e ujit. Masë tjetër agroteknike që kryhet gjatë qendrimit të fidanit në fidanishte është pastrimi i barishteve me qëllim që fidanët të rriten lirshëm e të shëndetshëm. Kur fidani arrin lartësinë 10-12 cm është i përshtatshëm për mbjellje në vendin e përhershëm. Përpara mbjelljes toka duhet të jetë e përgatitur mirë për mbjellje. Fidanishtja ujitet me ujë të bollshëm dhe fillon shkëlqja e fidanit. Rrënjët e çdo fidani priten në 1/3 e gjatësisë dhe baltohen (pak baltë, pleh i kalbur plotësisht, ujë dhe përzihen derisa masa të bëhet si llurbë e trashë. Me këtë masë lyhen përpara mbjelljes rrënjët e çdo fidani). Mbjellja bëhet me kunj, duke shtrënguar mirë fidanët e mbjellë me dheun. Largësia e mbjelljes bëhet 50 cm rreshti nga rreshti dhe 20 cm largësia e bimëve brenda rrjeshtit. Afati më i mirë për mbjellje është muaji Tetor, por sidoqoftë mbjellja duhet bërë kur toka ka lagështi të mjaftueshme. Në qoftë se e bëjmë me kujdes, mënyra më ekonomike është nxjerria e filizave të rrënjëzuar nga bimët mëmë. Trajtimi i filizave është i njëjtë si për fidanin e përgatitur në fidanishtë. Po ashtu edhe për këtë rast koha më e mirë është muaji Tetor. Filizat e nxjerra mbillen sa më parë, ndërsa në pranverë kontrollohet rrënja dhe zëvendësohen boshllëqet.

Mbjellja në arë drejpërdrejt me farë.

Fara merret nga bimët në natyrë në kohën e pjekies së plotë. Ajo përzihet më rërë në raportin 1:10. Si normë fare përdoren 10 kg/ ha, kurse mbjellja duhet të kryhet në gjysmën e dytë të muajit Mars. Distanca e mbjelljes janë ato që përmendëm (në qoftë se mbjellja do të bëhet me rreshta), por meqenëse fara është e imët, mbjellja me makinë të lashtash është vështirë të realizohet, prandaj bëhet shpërndarja me dorë.

Vjelja e prodhimit: Korrija fillon kur rreth 90 % e bimëve kanë lulëzuar. Kjo bimë vilet nga 20 Qershor deri në fund të Korrikut.

Degët e prera thahen në ndonjë hije pemësh pranë parcelës së prodhimit dhe pas tharjes së plotë, shkoqiten fletët dhe lulet nga kërcejtë dhe pastrohet përfundimisht malli e më pas hidhen në thasë të pastër. Malli i përgatitur për shitje duhet të përmbajë:

1. *Fletë dhe lule* të thara, të pastra nga bishtat e coptuar dhe lëndët e huaja.
2. *Aroma dhe shija* karakteristike e vetë bimës.
3. Nuk lejohen që fletët dhe lulet të jenë të mykura, të kalbura dhe të kenë papastërti të ndryshme.
4. *Lagështia* të mos jetë më shumë se 13 %.

3.2 Ciani (Kokoçeli)

Përshkrimi: Bimë barishtore një ose dy vjeçare. Kërcellin e ka të drejtë, të degëzuar, të lartë 30-60 cm. Gjethet i ka heshtake, të poshtmet me bisht tre rreshtash ose pendore me vringuj, të tjerat pa bisht dhe të plota. Lulet i ka me bisht të gjatë me ngjyrë të kaltër. Lulëzon gjatë muajve Maj-Qershor.

Përhapja gjeografike: Kokoçeli në vendin tonë takohet me shumicë në rrëzë të malit të Moravës si në: Devoll, Korçë, Pogradec, Peshkopi e gjetkë. Në natyrë rritet si bar i keq në tokat e mbjellë me grurë, thekër dhe bimë të tjera bujqësore. Takohet kryesisht në lartësitë mbi 500 m mbi nivelin e detit, ndërsa më rrallë në kullotat dimrore dhe ato subalpine.

Toka dhe klima: Preferon toka të pasura, por në fakt rritet në çdo lloj toke qofshin ato të varfëra

e të thata.

Afati dhe mënyra e mbjelljes: Lulja e cianit është shumë e kërkuar nga tregjet e eksportit dhe kultivimi i tij është me interes ekonomik. Fara e cianit mund të sigurohet nga kompanitë e eksportit të BMA-ve që bashkëpunojnë me fermerët në bazë të modelit të kontraktimit të fermës. Toka duhet të përgatitet në mënyrë të tillë që në momentin e mbjelljes të jetë e shkruftuar imët, gjë kjo që garanton mbulimin normal të farës. Afati më i mirë i mbjelljes është 20 Tetor - 20 Nëntor duke përdorur 4-5 kg farë për 1 ha. Mbjellja bëhet me rreshta me distancë 30-40 cm dhe brenda rreshtit fara hidhet zinxhir. Kjo mënyrë mbjellje mund të realizohet me makinat e mbjelljes së grurit (lloj makinash të tërhequra nga pendë) të përshtatshme për terrenet e thyera. Mjaft mirë realizohet mbjellja edhe me shpërndarje të farës me dorë. Në këtë rast fara përzihet me rërë (për lehtësi shpërndarje uniforme) në raport 1:10 (1 kg fare:10 kg rërë) dhe hidhet në tokë në thellësinë 0.5-1 cm dhe më pas bëhet ngjeshja me dërrasë. Në të gjitha rastet, në tokat e pjerrëta bëhen vijat e mbledhjes së ujrave për të eliminuar gërryerjen e tokës. Pas mbirjes shërbimet e para kulturore janë pastrimi i barishteve që konkurojnë bimën e mbjellë, si dhe në qoftë se ka mundësi edhe nitrifikimi me një dorë të lehtë nitrat.

Vjelja e prodhimit: Lulet e kokoçelit grumbullohen gjatë muajve Maj-Qershor, kur kanë çelur plotësisht. Vilet lulja së bashku me kupën ose vetëm petalet (vetëm pjesa blu e lules). Vjelja duhet të bëhet në kohë me diell dhe pasi të ketë kaluar vesa. Mënyra e tharjes është e njëjtë si tek lulet e tjera. Pas tharjes prodhimi vendoset në thasë të pastër dhe përgatitet për dorëzim dhe shitje me këto karakteristika cilësore:

1. *Pamja:* Lule të çelura, së bashku me kupën, të thata, me bisht jo më të gjatë se 0.5 cm.
Ngjyra: Lulja të ketë ngjyrë blu, ndërsa kupa e gjelbër në gri me nuanca kafe. Nuk lejohen të mykura, të kalbura, të nxira, insekte të gjalla ose të ngordhura dhe papastërti të ndryshme.
2. *Lagështira:* Jo më shumë se 14 përqind.
3. *Pjesë të ndryshme të vetë bimës:* Jo më shumë se 1 përqind.
4. *Lule me ngjyrë jo normale:* Jo më shumë se 3 përqind.
5. *Lule të paçelura ose kupë me petale të rëna:* Jo më shumë se 5 përqind.

6. *Lëndë minerale*: Jo më shumë se 0.5 përqind.

Në kushte të mira kultivimi, mund të merren 5-7 kv/ha lule ciani me kupë ose 1.5-3 kv/ha lule ciani pa kupë.

3.3 Mëllaga

Përshkrimi: Është bime barishtore një ose shumëvjeçare, që rritet deri në 30 - 50 cm lartësi. Nxjerr shumë kërcenj cilindrikë, të degëzuar. Gjethet i ka të këmbyera, të rrumbullakëta dhe të dhëmbëzuara me bisht deri 3 cm. Lulet i ka pak a shumë të mëdha me bisht 1-2 cm, me ngjyrë rozë në manushaqe të cilat dalin në sqetullat e gjetheve. Kupa përbëhet nga gjethëza gjatore me 5 vringuj në formë trekëndëshe. Kupa ka 5 petale. Ka shumë thekë. Frutat i ka në formë kulaçi, me ngjyrë të verdhë deri në gri-kafe, me diametër rreth 8 mm. Ato përbëhen nga 9-11 fara. Në vendin tonë në viset e ulëta dhe bregdet, lulëzimi fillon nga 15 Maji dhe vazhdon deri në fund të Shtatorit, kurse në viset e ftohta, lulëzimi fillon në Qershor dhe vazhdon deri në fund të Shtatorit.

Përhapja gjeografike: Rritet dhe zhvillohet thuajse kudo në vendin tonë, duke filluar nga bregdeti deri në 1300 m lartësi mbi nivelin e detit. Takohet me shumicë rrëzë Gramozit, në kodrinat dhe pllajat e Delvinës dhe Konispolit, në Vlorë, Berat, Bilisht dhe Dibër. Më pak takohet në Përmet, Tepelenë, Këlcyrë, Gjirokastrë, Elbasan, Peqin, etj. Megjithëse rritet kudo në gjendje të lirë, kultivimi i saj është me mjaft leverdi ekonomike.

Toka dhe klima: Meqenëse është e përhapur kudo, mund të themi se mëllaga nuk ka kërkesa të theksuara për tokë. Ajo i përshtatet thuajse të gjitha tokave si atyre të papunuara, në vende të braktisura, etj. Mëllaga rritet dhe zhvillohet në të gjitha klimat dhe mikroklimat e vendit tonë.

Afati dhe mënyra e mbjelljes: Për të marrë lule me cilësi të mirë, këshillohen mbjelljet e hershme në stinën e vjeshtës gjatë muajit tetor. Gjithashtu mbjellja e farës mund të kryhet dhe në pranverë, gjatë muajit prill. Fara për mbjellje sigurohet fillimisht nga bimët spontane. Ajo grumbullohet kur është e pjekur plotësisht, pastaj shkoqet, pastrohet dhe bëhet gati për tu mbjellë. Gjithashtu farën mund të sigurohet dhe nga kompanitë e eksportit të BMA-ve. Toka ku do të hidhet fara përgatitet

në mënyrë të tillë që gjatë mbjelljes të jetë e shkrifët dhe me vlagë me qëllim që fara të mbulohet mirë dhe të mbijë shpejt (2-3 javë pas mbjelljes). Mbjellja bëhet me makinë mbjellëse të lashtash, në rreshta me largësi 45-60 cm, ndërsa brenda rreshtit zinxhir. Në tokat ku nuk hyn makina, mbjellja bëhet me shatë duke hapur lehtësisht vija në distancat 30-45 cm dhe pastaj hidhet fara me dorë dhe mbulohet me shatë. Norma e farës për mbjelljen e mekanizuar shkon 5-7 kg/ha, ndërsa për mbjelljen me shatë 10-12 kg/ha. Shërbimet fillojnë rreth 2 javë pas mbirjes. Me prashitjen bëhet njëkohësisht edhe rrallimi duke i lënë bimët brenda rreshtit 30 cm larg njëra-tjerës. Pastaj shërbimet e tjera vazhdojnë me pastrimin e barishteve të “*këqija*” deri sa mëllaga të mbulojë mirë tokën. Në qoftë se është e mundur, prashitjet shoqërohen me plehërimë.

Vjelja e prodhimit: Mëllaga kultivohet për të marrë prej saj *lulet* dhe *gjethet*. Mëllaga e mbjellë herët në pranverë krijon masë të gjelbërt të pasur me lule. Në vitin e parë, lulëzimi fillon në fillim të Korrikut dhe vazhdon deri në Shtator, ndërsa në vitin e dytë në Qershor. Lulet këputen me dorë bashkë me kupën e lules. Vjelja bëhet me intervale 2-3 ditore, në ditë me diell, pa lagështi e vesë. Tharja bëhet në hije. Vjelja dhe tharja e luleve vazhdon 6-7 javë, derisa mbaron krejt lulëzimi i bimës. Raporti i lules së njomë me atë të thatë qëndron 5(6) me 1.

Në kushte të mira kultivimi mund të merren 7-10 kv/ha lule të thatë. Përveç lules, mëllagës i merret edhe gjethja duke ndjekur për tharje ato kritere që përmendëm për lulet. Vilen vetëm fletët e plota dhe të zhvilluara. Raporti është 4:1 (pra nga 4 kg fletë të njoma, pas tharjes merret 1 kg masë e thatë). Pas tharjes, prodhimi futet në thasë të pastër dhe sipas rastit bëhet ose jo me peshë standart dhe përgatitet për dorëzim dhe shitje.

Duhet theksuar edhe një herë se lulet e mëllagës jo vetëm nuk duhet të thahen në diell, por edhe pas tharjes, prodhimi nuk duhet ta zënë rrezet e diellit, pasi në këto raste lulet çngjyrosen dhe nuk kanë më vlerë. Prodhimi i lules i përgatitur për dorëzim e shitje duhet të ketë këto karakteristika:

- *Pamja:* Lule të çelura sëbashku me kupën e tyre, me bisht jo më të gjatë se 2 cm, të thata.
- Aromë karakteristike të vetë bimës, me shije mulciloze.
- *Ngjyra:* Lule me ngjyrë manushaqe të errët, manushaqe të çelur dhe kupa e gjelbërt e çelur. Nuk lejohen të kalbura, të nxira, papastërti të ndryshme dhe insekte të gjallë ose të

ngordhur.

- *Lagështia*: Jo më shumë se 14 përqind.
- *Lule me ngjyrë jo normale*: Jo më shumë se 6 përqind.
- *Lëndë organike të vetë bimës*: Jo më shumë se 3 përqind.
- *Lëndë minerale*: Jo më shumë se 0.5 përqind.

Ndërsa prodhimi i fletëve përgatitur për dorëzim dhe shitje, duhet të ketë këto karakteristika:

1. *Pamja*: Fletë të zhvilluara, të thata, të plota pjesërisht të coptuara, me bishtin e tyre natyral jo më të gjatë se 2 cm, pa erë, shije specifike e vetë bimës (mulciloze), fletë pa njolla ndryshku, të pabrejtura nga insektet.
2. *Ngjyra*: E gjelbërt, e gjelbërt e hapur. Nuk lejohen fletë të nxira, të mykura, të kalbura dhe papastërti të ndryshme.
3. *Lagështia*: Jo më shumë se 12 përqind.
4. *Fletë të copëtuara*: Ø 3 mm: Jo më shumë se 3 përqind.
5. *Fletë me ngjyrë jo normale*: Jo më shumë se 5 përqind.
6. *Lëndë organike të vetë bimës*: Jo më shumë se 3 përqind.
7. *Lëndë minerale*: Jo më shumë se 0.5 përqind.

3.4 Kalendula

Përzgjedhja e farës

Përzgjedhja e farës është një hap shumë i rëndësishëm si për kultivimin e kalendulës si për çdo kulturë tjetër. Është mirë që fermerë të zgjedhin farëra të çertifikuara, të cilat garantojnë bimë të shëndetshme me fuqi të lartë lulëzimi dhe me rendiment të lartë të vajit esencial. Vlerësohet se

1000 fara kalendula peshojnë afërsisht 8,5 deri në 9 g. Fuqia mbirëse e farërave të certifikuara është zakonisht mbi 85%, edhe pse kjo zvogëlohet me kalimin e kohës. Dy vjet pas vjeljes, farat konsiderohet se e humbasin plotësisht fuqinë e tyre mbirëse.

Afatet e mbjelljes

Në zonën e Dibrës, kalendula mbillet dy herë në vit: në vjeshtë gjatë periudhës shtator – tetor dhe në pranverë, gjatë muajit prill. Këshillohet më së shumti, që fermerët ta mbjellin kalendulën në vjeshtë, pasi bima bimë ka një cikël më të gjatë, hyn në prodhim me herët dhe ka rendiment më të lartë. Norma e farës së përdorur për mbjellje është 15 – 20 kg/ha.

Mbjellja

Mbjellja e kalendulës bëhet drejtpërdrejt me anë të shpërndarjes së farës në tokë. Këshillohet distanca midis rreshtave të jetë 50 deri në 70 cm, ndërsa distanca e bimëve në rresht të jetë rreth 30 cm. Kjo shpërndarje siguron 45,000 deri në 50,000 bimë për hektar. Thellësia e mbjelljes së farës duhet të jetë 2 – 3 cm.

Mbjellja e kalendulës mund të kryhet gjithashtu dhe me anë të fidanëve. Fidanët janë të gatshëm për mbjellje zakonisht 40 – 50 ditë pas mbjelljes në fidanishte dhe kur të kenë arritur gjatësinë 10 cm.

Shërbimet agro – teknike gjatë kultivimit

Shërbimet e bimës janë të lidhur kryesisht me heqjen e barërave të këqija dhe kontrollin e sëmundjeve dhe dëmtuesve. Këshillohet që, aty ku është e mundur, të bëhet heqja e mekanuar e barërave të këqija midis rreshtave përmes një kultivatori, i cili bën gjithashtu dhe shkrifëtimin dhe ajrimin e tokës. Nëse kjo nuk e mundur, fermerët mund të heqin barërate këqija dhe ta prashisin bimët me shatë.

Në tokat e varfra duhet të bëhet plehërimi i tokës. Për të pasur një prodhim organik dhe të cilësisë së lartë, këshillohet përdorimi i plehërave organike të kompostuara. Për të marrë rendiment të larta, këshillohet të kryhen dy ujitje në javë gjatë kohës së vegjetacionit. Gjithashtu këshillohet që të kryhet një ujitje pas çdo vjelje të luleve.

Vjelja

Vjelja behët kur lulet janë në lulëzim të plotë. Heqja e luleve të vyshkura është një praktikë shumë e rëndësishme për zgjatjen e periudhës së vjeljes. Vjelja e kupave të kalendules (pjesa e nënpetaleve përfshirë dhe petalet) bëhet me dorë. Vjelja bëhet pasi lulet të jenë të hapura plotësisht në ditë me diell dhe pasi të ketë rënë vesa. Vlerësohet se gjatë një sezoni kryhen 10 – 12 vjelje.

Rendimenti

Rendimenti i luleve të thara të kalendulës është në varësi të disa faktorëve: pjelloria e tokës, kushtet klimaterike, kryeja e shërbimëve agro teknike, etj. Nëse kryhen shërbimet e duhura në kohën e duhur dhe kushtet e motit janë të favorshme, mund të merren 200 – 300 kg lule kalendule të thara në vit. Rënia e rendimentit lidhet me kullimin e dobët të tokës, praninë e barërave të këqija, mbjellja e bimës jashtë afatave të përcaktuara, etj.

3.5 Agulicja

Përshkrimi: Është bimë shumëvjeçare me gjethe vezake ose vezake gjatore me një bisht me flatra të gjera. Lulet janë në ngjyrë të verdhë ose në ngjyrë ari të vendosura në lulesa të përkulura. Kupa është në formë kambane me diametër 8 - 20 mm, ndërsa kurora ka diametër 8 – 30 mm.

Përhapja: Rritet spontanisht në pyje, livadhe dhe deri në kullotat subalpine.

Klima dhe toka: Rritet pothuaj kudo, nuk ka shumë kërkesa për token apo klimën.

Afati dhe mënyra e mbjelljes: Fillimisht fara sigurohet nga bimësia spontane pasi luleve tu ketë filluar rrënia e petaleve (në fazën e fillimit të tharjes së luleve). Në këtë kohë vilen me kujdes lulet, thahen mirë që të shkoqen lehtësisht. Materiali bimor i shkoqur nuk mund të ndahet nga fura për

këtë arsye për mbjellie hidhet i gjithë materiali i lules së shkoqur. Meqenëse fara është e imët, duhet të mbillet në toka të shkriptuara mirë. Mbillet në periudhën shtator tetor duke përdorur rreth 6 kg farë për ha.

Gjatë mbjelljes fara përzihet me rërë në raport 1:10 (1 kg farë : 10 kg rërë) dhe hidhet në tokë në një thellësi prej rreth 2 cm, pastaj ngjishet me dërrasë përsipër. Fara shpërndahet uniformisht me dorë. Si shërbim pas mbjelljes kryhet pastrimi i barishteve që konkurrojnë bimësinë e mbjellë, ndonjë plehërim organik dhe prashitje për largimin e barërave të këqija dhe ajrimin e tokës.

Vjelja e prodhimit: Fillon kur lulet kanë hyrë në fazën e lulëzimit të plotë nga mesi i prillit dhe në maj. Vjelja bëhet manualisht në kohë të kthjellët. Pas tharjes prodhimi vendoset në thasë të pastër dhe bëhet gati për dorëzim dhe shitje.

Trajtimet pas vjeljes së bimëve aromatike dhe mjekësore

Pavarësisht se fermerët mund të menaxhojnë shumë mirë kultivimin dhe vjeljes e bimëve aromatike dhe mjekësore, është shumë e rëndësishme që ai të aplikojë praktikën e duhura në pasvjelje pasi ky është një proces shumë delikat. Një menaxhim i keq mund të shkatërrojë produktet e vjelja dhe të humbasë cilësisë e tyre. Bimët e vjela duhet të ruajnë vetitë e tyre fizike (ngjyrën, aromën, pamjen e jashme), kimike (pëmrbahtjen e vajrave esencialë) dhe higjenike (mungesa e mikroorganizmave patogjenë). Na trajtimet e pasvjeljes janë të përfshira aktivitetet e mëposhtme:

- *Tharja*

Tharja është trajtimi pas vjeljes i BMA-ve të vjela përmes së cilës largohet lagështia. Të gjitha bimët mjekësore kalojnë në një proces tharjeje, pasi në formë të thatë ato mund të magazinohen për një kohë të gjatë dhe janë më të lehta për t'u menaxhuar.

Tharja mund të jetë natyrale ose artificiale.

Këshillohet që tharja natyrale të kryhet në hije të pemëve pranë parcelës së prodhimit ose në vendë të tjera të caktuara për këtë qëllim. Pjesët e vjela të bimëve, duhet të cohen për tharje menjëherë pas vjeljes. Duhet të bëhet kujdes që bimët e vjela të vendosen mbi fletë tekstile të pastra dhe të

sigurohemi që nuk kalojnë bagëtitë dhe kafshët mbi to. Zakonisht, tharja natyrale në hije shkon 8 – 12 ditë, në varësi të llojit të bimës, pjesës së vjelë dhe temperaturës. Bimët aromatike dhe mjekësore nuk këshillohen që të thahen në kohë të vrenjtur. Ato duhet të thahen në kohë me diell dhe gjithmonë nën hije. Në diell mund të thahen vetëm rrënjët dhe frutat.

Është shumë e rëndësishme që tharja e BM-ve të bëhet sa më shpejt, pasi në këtë mënyrë pengohet zbërthimi dhe avullimi i lëndëve esenciale. Pra, me tharjen e shpejtë të bimëve arrijmë të ruajmë ngjyrën natyrale të bimës dhe përmbajtjen e vajrave esencialë.

Për rrjedhojë, këshillohet që fermerët të aplikojnë tharjen artificiale të bimëve aromatike. Kjo mund të kryhet në tunele të vegjël plastike, të cilët kanë të përfshirë një ventilator të ajrit në hyrje të tyre. Bimët e vjela vendosen mbi shtretër tekstile rreth 1 m nga toka dhe në to fryhet ajri përmes një ventilatori. Ky proces mundëson tharjen e luleve në rreth 1 deri në dy dytë dhe ruan cilësinë e tyre.

- *Paketimi i bimëve aromatike dhe mjekësore*

Pas tharjes, bimët menjëherë duhet të pakëtohen, e sidomos bimët që thithin më shumë lagështi. Ato bimë pakëtohen me paketim të dyfishtë prej letre (disa lule dhe gjethe). Disa lloje bimësh pas tharjes copëtohen lehtë. Që të mos ndodhë një gjë e tillë, këto bimë duhet t'i lëmë të ftohen gjatë gjithë natës, e pastaj t'i pakëtojmë. Është me rëndësi të dimë se gjatë paketimit nuk duhet të bëjmë shtypjen e bimëve dhe duhet të jemi të kujdesshëm që të pakëtohen vetëm bimët e pastruara nga papastërtitë e ndryshme organike e inorganike. Ka ambalazhe të ndryshme për paketimin e bimëve, në varësi se cilën pjesë të bimës së tharë pakëtojmë (letër, karton, qese etj).

Ambalazhi ka rëndësi të veçantë për ruajtjen e këtyre barnave nga lagështia, drita, papastërtia, temperatura, insektet e ndryshme etj. Çdo paketim duhet të ketë etiketën me emrin e bimës dhe shënime të tjera të nevojshme, si: klasa, viti i vjeljes dhe mundësisht edhe origjina e bimës. Depot për grumbullimin e këtyre bimëve mjekësore duhet të jenë të thara, të pastra dhe të ajrosura. Në fund duhet të theksojmë se të gjitha bimët mjekësore dhe aromatike nuk duhet të ruhen më shumë se një vit e disa specie edhe më pak, sepse e humbasin cilësinë e tyre. Në mënyrë që t'i ruajmë më mirë, është e mundur që BMA-të t'i pakëtojmë përmes presimit.

- *Kushtet teknike për ruajtjen në magazinë të bimëve aromatike dhe mjekësore*

Bimët aromatike dhe mjekësore ruhen në magazina ose ambiente të pastra, të ajrosura, pa lagështi, me hapësirën dhe ndriçimin e nevojshëm, ku rrezet e diellit nuk bien direkt mbi to. BMA-të nuk vendosen direkt mbi dysheme, por sipër saj vendosen dërrasa ose paleta druri në një lartësi 10-15 cm dhe mbi dërrasa vendosen thasët me bimë.

Po ashtu thasët me bimë, vendosen rreth 50 cm larg mureve të magazinës apo ambienteve të tjera. Thasët stivohen nga 4-7 copë njëri mbi tjetrin, ndërsa në stinën e thatë të verës, sipas nevojës mund të vendosen në lartësi edhe më të mëdha.

Gjatë sistemimit të mallit në magazinë duhet të lihet rrugë kalimi për të kontrolluar gjendjen e bimëve dhe për të bërë manipulimet e nevojshme. Në çdo 3 deri 4 rradhë me thasë lihet rrugë kalimi. Në qoftë se malli qëndron për një kohë të gjatë në magazinë, çdo muaj bëhet lëvizja e tij me qëllim ajrosjen, duke i nxjerrë thasët e fundit përsipër dhe anasjalltas.

Gjatë kësaj pune bëhen edhe kontrole mbi gjendjen cilësore aktuale. Duhet mbajtur parasysh se disa disa BMA (si rrënja e sanzit, gramit, shpatores, lëvorja e drunakuqit etj) janë mjaft higroskopikë, prandaj duhen ruajtur në vende të thata e pa lagështi ajrore. Ambientet ku ruhen artikujt bimore duhet të jenë gjithnjë të pastra nga pluhurat, merimangat, etj. Po kështu malli i vendosur për ruajtje duhet të sistemohet bukur.

Depot ku ruhen BMA-të janë një terren i përshtatshëm për zhvillimin e insekteve të ndryshme. Prania e insekteve në prodhimet bimore e nxjerr të pavlefshëm dhe jashtë përdorimit mallin. Në këtë rast marrja e masave mbrojtëse është e domosdoshme, por si malli ashtu edhe ambalazhi nuk duhet të kenë kontakt direkt me insekticidin që do të përdoret. Masa mbrojtëse duhen marrë gjithashtu për mbrojtjen nga zjarri.

Sipas tregut të shitjes, bëhet edhe ambalazhimi i mallit. Përgjithësisht produktet ambalazhohen në thasë standard ku jepet pesha neto dhe bruto. Më pas bëhet marketimi i tij. Transporti i bimëve aromatike dhe mjekësore të thara bëhet me çdo lloj mjeti të pastër dhe të mbuluar kur koha është me shi.

4. Identifikimi i pesë vendeve më të mundshme për kultivimin e BMA-ve

BMA-të e cituara më sipër mund të kultivohen shumë mirë në tokat bujqësore të qarkut Dibrës. Në tabelën e mëposhtme jepet një përmbledhje se në cilat Njësi Administrative mund të kultivohen BMA-të e përzgjedhura.

Nj. Administrative	Rigoni	Ciani	Mëllaga	Kalendula	Aguliçja
Maqëllarë	x	x	x	x	x
Muhurr	x	x	x	x	x
Melan	x	x	x	x	x
Kastriot	x	x	x	x	x
Sillovë			x	x	x

Përgjithësisht këto 5 BMA mund të kultivohen shumë mirë në pesë Njësitë Administrative të Parkut Kombëtar Korab – Koritnik: Maqëllarë, Muhurr, Melan, Kastriot dhe Sillovë.

Faktorët kryesorë që ndikojnë në cilësitë fiziko – kimike të bimëve aromatike dhe mjekësore janë klima dhe kushtet agro – ekologjike të tokës.

Për sa i përket klimës, duhet të merret parasysh kohëzgjatja e ditës, sasia e reshjeve dhe amplituda e temperaturave. Këta faktorë kanë ndikim të drejtpërdrejtë në proceset fiziologjike dhe biokimike të bimëve, veçanërisht ato që përfshijnë reaksione enzimike, që ndikojnë në zhvillimin e bimëve dhe biosintezën e lëndës organike.

Kushtet klimaterike duhet të jenë të favorshme për kultivimin e BMA-ve. Ato duhet të jenë të njëjta ose të ngjashme me kushtet klimaterike të rritjes së bimëve në habitatet e tyre natyrale. Fakti se disa nga bimët e përzgjedhura në këtë studim si: rigoni, mëllaga dhe aguliçja gjenden në habitate natyrale të florës spontane të kësaj zone është një tregues se kushtet klimaterike të këtyre zonave të Dibrës janë të favorshme për kultivimin e tyre. Ndërkohë, ciani dhe kalendula, më së shumti janë bimë që kultivohen dhe që gjejnë kushte të përshtatshme klimaterike në zonën e Dibrës.

Fermerët duhet të tregojnë kujdes në përzgjedhjen e vendeve për kultivimin e këtyre BMA-ve. Bimët që kultivohen kërkojnë vende me diell, të ajrosura mirë, të mbrojtura nga erërat e forta dhe të sigurta nga ngricat e dimrit.

Toka duhet të jetë pjellore dhe të përmbajë sasi të nevojshme të makroelementëve (N,P,K), mikroelementëve, dhe lëndës organike për një zhvillim optimal të bimëve. Çdo bimë aromatike dhe mjekësore ka kërkesa specifike për lëndët ushqyese. Këshillohet që para kultivimit, të kryhet një analizë e tokës për të kuptuar përmbajtjen e lëndës ushqyese dhe pjellorinë e saj. Nëse arrihet në përfundimin se toka ka përmbajtje të ulët të elementëve ushqyes të caktuar, atëherë kryhet plehërimi i tokës. Vlen të theksohet gjithashtu se shumica e bimëve aromatike dhe mjekësore kërkojnë një pH neutral të tokës (midis 6,5 – 7.5).

Qarkullimi bujqësor është shumë i rëndësishëm. Këshillohet që të bëhet qarkullimi i BMA-ve me kultura të tjera pasi kjo ndikon në pjellorinë, bilancin ujqor dhe organik të tokës, mbron bimët nga sëmundje dhe dëmtues të ndryshëm, si dhe nga barërat e këqija. Kulturat bujqësore më të përshtatshme për qarkullimin bujqësor janë bishtajoret (bizelja, fasulja, thjerrëza, batha, jonxha, etj). Një bimë aromatike dhe mjekësore duhet të mbillet në të njëjtët toke 1 – 3 vite. Pas vitit të tretë, prodhimi bie dhe bimët janë më të ekspozuara ndaj dëmtuesve dhe sëmundjeve.

5. Përfundimet / Konkluzionet

- Ka një potencial të lartë për kultivimin e BMA-ve në qarkun e Dibrës që nuk është vlerësuar si duhet deri më sot .
- Me interes të veçantë për kultivim janë BMA të tilla si: rigoni, ciani, mëllaga, kalendula dhe aguliçja.
- Në rast mbështetjeje me skema subvencionimi, kultivimi i BMA-ve të tilla si sanzi, salepi dhe trëndafili i egër do të ishte me shumë interes për fermerët e qarkut Diber.
- Zonat e përshtatshme për kultivimin e BMA-ve përfshijnë njësitë administrative pranë parkut kombëtar Korab – Koritnik, Maqellarë, Melan, Muhurr, Sillove, Kastriot.
- Kultivimi i BMA-e mund të shtrihet shumë mirë dhe në zona të tjera
- Është e nevojshme një koordinim më mirë midis aktorëve të zinxhirit të vlerës për aktivitete me interes të ndërsjellë përmes modelit të “ kontraktimit të fermave - contract farming”